

BASHKIA KOLONJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

4. Autoriteti: Bashkia Kolonjë

Adresa Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax +355 812 23173 ; 08122225 ; 2232
E-mail bashkia.kolonje@gmail.com
Faqja e Internetit <http://www.kolonja.gov.al>

5. Dhënie me qira të fondit pyjor dhe kullor në përdorim, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr Lotit	Njësia Administrative	Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Nr. Parcelës Pyjore	Objekti veprimtarisë.	Sipërfaqja		Vlera dysheme e qirasë Lekë/vit/ha	Kohëzgjatja (Vite)
						Ha	Km		
7	Qëndër Ersekë, Pranë fshatit Psar, Ekonomia Pyjore Qëndër Gramoz	3066	565	25/a	Për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash,	0.2 ha		110,000	10

					shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj				
8	Qëndër Ersekë, Pranë fshatit Borovë e Kagjinas, Ekonomia Qëndër Novoselë	1251 dhe 2025	731 dhe 553	28 dhe 34/c	Për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.	37 ha		176,000	10
T O T A L I									

6. Qëllimi i dhënies me qira të fondit pyjor dhe kullësor, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, është dhënia në përdorim me qira për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj dhe zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.
7. Konkurrimi do të zhvillohet më datë: 04.04.2024, ora 11:00, në Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.
8. Çmimi dysheme i qirasë, është
Loti nr.7 lloji Pyll, trungishte në vlerën: 110,000 (Njëqinddhjetëmijë) lekë/ha në vit.
Loti nr.8 lloji Kullotë në vlerën: 176,000 (Njëqindshatatëdhjetëegjashtëmijë) lekë/ha në vit.
9. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë tej afatit 10 (dhjetë) vjet.

Loti nr.7 Për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj.

1. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
 - a) Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
 - b) Çertifikatën e regjistrimit
 - c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, (i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
 - d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - e) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme
 - f) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
 - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
 - h) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;
 - i) Afati i qirasë.
 - j) Adresës e subjektit, telefonin, e-mail dhe faks.

- k) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
- l) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
- m) Vërtetim për shlyerjen e taksave,tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2023 dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara),duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
- n) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
2. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
3. Sigurimi i ofertës
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës,
Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së fondit limit.
Llogaritja bëhet:Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.
4. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet,(i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen 15 pikë.
- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes.....25 pikë.
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari.....5 pikë.
- e) Masën e qerasë për ha/vit35 pikë.

Loti nr.8 Për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.

1. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
- a) Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
- c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar,(i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi,

- objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
- d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - e) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
 - f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
 - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
 - h) Raportin e vlersimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
 - i) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;
 - j) Afati i qirasë.
 - k) Adresës e subjektit, telefonin, e-mail dhe faks.
 - l) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
 - m) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
 - n) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2023 dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
 - o) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
2. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
3. Sigurimi i ofertës
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës, Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së fondit limit. Llogaritja bëhet: Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.
4. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, (i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
 - b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen 15 pikë.
 - c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes.....25 pikë.
 - d) Nivelin e punësimit në veprimtari.....5 pikë.
 - e) Masën e qerasë për ha/vit35 pikë.

5. Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokure origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 7 (shtatë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkuresit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.
6. Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 04.04.2024, para orës 11:00.